

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Në çështjen juridike të :**AC-I.-21-0087-A0001***Paditësi/Ankuesi***Sh K**, me përfaqësues sipas autorizimit, av B I, Prishtinë**Kundër:***E paditura***N.SH. “Fapol”,** Podujevë (në likuidim), **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishtë, Prishtinë”

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-0347, të datës 6 janar 2021, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 03 shkurt 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-0347, i datës 6 janar 2021.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 21 prill 2015, ankuesi ka parashtruar një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN023-0054 të datës 11 mars 2015, me të cilin vendim kërkesën e paditësit për kompensim për paga të papaguara për periudhën prej 1 tetor deri më 24 tetor 2014 në shumën prej 358.29 € nga N.SH “F” (në likuidim), e kishte refuzuar si të pavlefshme për shkak se marrëdhënia e punës së paditësit është ndërprerë me 1 tetor 2014, kur edhe Autoriteti i Likuidimit kishte njoftuar të gjithë punëtorët e ndërmarrjes për fillimin e procedurës së Likuidimit dhe ndërprerjen e të gjitha kontratave të punës. Prandaj, si rrjedhojë e kësaj N.SH në fjalë nuk ka asnjë detyrim kundrejt parashtruesit të kërkesës për periudhën pas fillimit të procedurës së Likuidimit të ndërmarrjes.

Në ankesë theksohet se vendimi i Autoritetit të Likuidimit është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se me datë 24 tetor 2014 ishte bërë pranim dorëzimi i vendimeve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për të gjithë punëtorët dhe stafin udhëheqës të ndërmarrjes, që do të thotë se ankuesi deri me këtë datë kishte punuar në këtë ndërmarrje si dhe konsideron që në mënyrë të gabuar është zbatuar edhe e drejta materiale, pasi që referimi i AL të N.SH. “F” në nenin 8 është i gabuar pasi që kjo dispozitë ligjore duhet të përcillet vetëm me një veprim konkret procedural e që është dorëzimi i vendimit apo letër pezullimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës nga AL përkatëse. Ankesës si provë i kishte bashkëngjitur: kopjen e Kontratës së punës të datës 1 korrik 2013 ndërmjet N.SH. “F” dhe Shaban Kamerollit, Regjistrin e pagave mujore të N.SH “F”, Njoftimi i shpallur për paraqitjen e kërkesave, Forma e dorëzimit pranimit të vendimeve për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Njoftimi për fillimin e likuidimit të N.SH “F”, vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN023-0054 të datës 11 mars 2015 dhe Prokurën speciale për përfaqësim.

Me datë 1 dhjetor 2020, AKP e paraqet mbrojtjen e saj në të cilën thekson se AL kishte konstatuar se parashtruesi në rastin konkret nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 për AKP-në është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 31 të Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin

për AKP-në. Prandaj, në pajtim me qëndrimin e vet parashtruesit vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit për AKP-në dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin. Tutje, thekson se marrëdhënia e punës së parashtruesit të kërkesës me N.SH “F” është ndërprerë me datë 1 tetor 2014 prandaj ndërmarrja në fjalë nuk ka asnjë detyrim kundrejt parashtruesit të kërkesës për periudhën pas fillimit të procedurës së Likuidimit të ndërmarrjes. Andaj, kishte propozuar që të refuzohet ankesa si e papranueshme ose e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e AL me nr. PRN023-0054 të datës 11 mars 2015, Vendimin për emërimin e anëtarëve të AL dhe Njoftimin e AKP drejtuar paditësit Sh K për fillimin e likuidimit të ndërmarrjes “F” të datës 14 tetor 2014.

Me datë 6 janar 2021, shkalla e parë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-15-0347, ankesën e paditësit e kishte refuzuar si të pabazuar, ndërsa kishte vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN023-0054 të datës 11 mars 2015. Në arsyetimin e Aktgjykimit shkalla e parë arsyeton se gjykata kishte shqyrtuar provat e palëve ndërgjyqëse dhe kishte konstatuar se paditësi ishte punëtor i të paditurës N.SH “F” por që kontestuese në këtë çështje është e drejta subjektive për kompensimin e pagës për periudhën 1 tetor 2014 deri më 24 tetor 2014. Tutje, konsideron se gjykata me provën e njoftimit publik për të gjithë kreditorët kishte vërtetuar faktin se periudha për ushtrimin e kërkesave kreditore ka filluar nga data 8 tetor 2014 deri më 21 nëntor 2014, njoftim ky të cilin paditësi e ka pranuar me 24 tetor 2014.

Gjykata në rastin konkret kishte vlerësuar se sipas ligjit, me marrjen e vendimit për fillimin e procedurës së likuidimit nga Bordi i AKP me datë 26 gusht 2014, me të cilin vendim datë e fillimit të likuidimit ishte caktuar të jetë data 1 tetor 2014, pra paditësit është ndërprerë marrëdhënia e punës me 1 tetor 2014 dhe në këtë rast momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës nënkupton edhe ndërprerje të çdo obligimi në aspektin e përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga marrëdhënia ndërmjet punëdhënësit dhe punonjësit, e në rastin konkret nga data 1 tetor 2014.

Paditësi me datë 5 shkurt 2021, brenda afatit të paraparë ligjor kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së C-IV-15-0347 të datës 6 janar 2021, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar

Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që ankesa e paditësit të miratohet si e bazuar, ndërsa të anulohet aktgjykimi i shkallës së parë ashtu që të obligohet e paditura që ankuesit t'i bëjë kompensimin e pagave të papaguara për periudhën kohore nga 1 tetor 2014 deri më 24 tetor 2014 në shumën prej 358.29 euro, duke përfshirë edhe kamatën e kalkuluar sipas nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së dhe kamatë vonësën sipas ligjit në fuqi, si dhe kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Ankuesi, thekson se as AL e as DHPGJS nuk e kanë kontestuar faktin se ankuesi ishte punëtor i NSH-së, faktin e pagesës si dhe lartësinë e kompensimit. Ankuesi pretendon se gjykata ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, përkatësisht nenin 8 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP-në, për arsye se kjo dispozitë ligjore duhet të përcillet me një veprim konkret procedural nga ana e AL-së dhe që është dorëzimi i vendimit apo letër pezullimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Ndërsa, sa i përket konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, sipas ankuesit më 24 tetor 2014, AKP-ja ia ka dërguar punëtorëve një shkresë me anë të cilës e ka konfirmuar se me datë 24 tetor 2014 është bërë pranim-dorëzimi i vendimeve të AKP-së mbi shkëputjen e marrëdhënies së punës për ish-punëtorët e NSH-së.

Pra, ankuesi i është përmbajtur udhëzimeve të njoftimit të AKM-së dhe kur ka filluar procesi i likuidimit brenda afatit të paraparë ligjor kishte parashtruar kërkesën e tij, pra nuk mund të flitet se e paditura nuk ka pasur detyrim rreth punëtorëve. Ankuesi në rastin konkret kishte kërkuar shumën prej 358.29 € duke mos e llogaritur deri në përfundim të muajit tetor por deri në pranimin e njoftimit për shkëputjen e marrëdhënies së punës dhe arsyeja pse nuk mund të kishte lista të pagave të muajit tetor 2014 ishte sepse listat e pagave hartoheshin në fund të muajit, ndërsa pas ndërprerjes askush duke përfshirë edhe menaxhmentin nuk kishte pasur autorizim të hartoj dhe lëshoj lista të pagave. Sipas ankuesit, Ligji i Punës të Kosovës 03/L-212, neni 55 pika 1, garanton të drejtën për kompensimin e pagës. Prandaj, duke pasur parasysh të lartcekurat kishte propozuar si më lartë. Ankesës i kishte bashkëngjitur si provë: Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kopjen e librezës së punës në emër të A R Sh, njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe kopje të librezës së punës në emër të N H, njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe kopjen e librezës së punës në emër të R A dhe një formë të dorëzimit pranimit të Vendimeve të AKP-së të datës 24 tetor 2014, ora 11:45.

AKP-ja në përgjigjen e saj në ankesë të datës 26 shtator 2022, thekson se e njëjta i përmbahet qëndrimit se argumentet e ngritura në ankesë janë të përsëritura dhe kërkesa e paditësit është e pabazuar, prandaj propozon që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Kolegji i Apelit konsideron se ankuesi nuk e ka bërë të besueshme ankesën e tij pasi që nuk ka parashtruar dëshmi valide për njohjen e të drejtës së pretenduar. Përkundër pretendimeve ankimore për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për aplikim të gabuar të të drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike nga shkalla e parë e DHPGJS-së, Kolegji i Apelit ka gjetur se këto pretendime nuk janë të besueshme, e aq më pak të faktuara e të bazuara.

Kolegji i Apelit gjeti se edhe AL i AKP-së edhe Shkalla e parë e DHPGJS-së kishin konstatuar se kërkesa nga paditësi ishte bërë në kundërshtim me nenin 8 të Shtojcës së Ligjit mbi AKP-në.

Kolegji i Apelit gjeti se paditësi kishte një kontratë pune me të paditurën për kohë të caktuar, deri në privatizimin e NSH-së. Me fillimin e procesit të likuidimit, të gjithë të punësuarve u ishte ndërprerë marrëdhënia e punës, e në mesin e tyre edhe paditësit. Kjo ndërprerje korrespondon me kontratën që ky punëtor kishte me NSH-në. Provat e ofruara nga paditësi nuk tregojnë asgjë lidhur me kërkesën për pagat për periudhën 1 tetor deri më 24 tetor, që është kërkesë e paditësit/ankuesit.

Paditësit i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës më 1 tetor 2014 si rezultat i fillimit të procesit të likuidimit të NSH-së, andaj ai nuk ka pasur kontratë pune në NSH pas kësaj date. Për këtë arsye, nuk ka asnjë bazë ligjore që të njëjtut t'i njihet e drejta për një pagë pas kësaj date. Të

gjitha këto janë dhënë në mënyrë të qartë në aktgjykimin e ankimuar, andaj Kolegji i Apelit e mbështet këtë arsyetim në tërësi.

Kolegji i Apelit nuk i pranon pretendimet ankimore në shkallë të dytë se ishte obligim i AL të AKP-së për t'ia dorëzuar vendimin, apo letër pezullimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Kontrata e punës ishte shumë e qartë- “deri në privatizim”. Në këtë rast nuk ishte e domosdoshme që të merret një vendim, apo të dërgohej një letër pezullim sepse me këtë kontratë dhe me ato kushte ishte pajtuar edhe vetë paditësi.

Nuk është i bazuar as pretendimi tjetër se, konform Ligjit të Punës në Kosovë, nenit 55 pika 1, i punësuari ka të drejtë në pagë e cila përcaktohet me kontratën e punës në pajtim me këtë ligj. Pikërisht është vepruar konform kësaj kontrate, sepse ajo kishte përcaktuar punësimin me kohë të caktuar deri në privatizim, andaj këtu nuk është gjetur asnjë shkelje e pretenduar.

Sa i përket kërkesës për kamatën të kërkuar nga ankuesi, Kolegji i Apelit konstaton se pasi që kërkesa kryesore është refuzuar, fatin e njëjtë e bartë edhe kjo kërkesë për kamatën.

Kolegji i Apelit ka shqyrtuar edhe kërkesën e paditësit për kompensimin e shpenzimeve gjyqësore. Në bazë të nenit 11 lidhur me nenin 62.2 të LDHPGJSK-së, pala paditëse që e ka humbur këtë kontest obligohet që palës tjetër t'ia paguaj shpenzimet procedurale. Meqenëse pala tjetër nuk ka kërkuar kompensimin e këtyre shpenzimeve, konform nenit 450 të LPK-së, secila palë vetë i bartë shpenzimet që i ka shkaktuar me veprimet e veta procedurale.

Nga këto arsye si më lartë, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi në bazë të nenit 13.9 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22.03.2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që vlera e kontestit është më pak se 1000 euro.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 03 shkurt 2023.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues
